

HALIL DERVISHAJ

ANTON PASHKU: KODET E MËDHA

Anton Pashku është njëri ndër shkrimtarët më të rëndësishëm shqiptar të Kosovës për të cilin është shkruar e folur shumë.

Ai është cilësuar si i veçantë dhe prijës i modernitetit ndër ne.

Me modernitetin pashkian nënkuptojmë fazën e dytë të modernitetit shqiptar, duke ju referuar studimit të Sabri Hamitit me titull: “Shkollat letrare shqipe”¹, që këtë shkollë letrare e nxjerr si vazhduese të asaj të viteve 30-të, të shekullit XX.

Ai përmes një strukturimi të ri stilistik e formal, i hapi rrugës imanencës së tij krijuese, që ishte prirje e shkrimeve moderne, ndërsa si ide ai kap pikat dominonte të etnisë sonë kombëtare, ku nëpërmes fiksionit, arrin që të vërtetën nacionale “reale” ta transformojë në të vërtetë letrare, që në botën e literaturës shqipe shihet si një plotësim i segmentit histori-literaturë, një mimesis i kësaj të parës, (duke qenë si njëra ndër çështjet më universale në botën e letërsisë, nga të cilat burojnë shumë tema, nëntema, motive, ide etj.).

Studimi im me shenjues “Kodet e mëdha”, do të bëjë një analizë stilistike e semantike, me referencë romanin “Oh” të Pashkut, për të trajtuar këtë roman si një sistem shkrimi të menduar mirë që më herët, në të cilin përfshihen elemente të kodeve të mëdha (ai historik, biblik dhe popullor e jo ai heroik), të reflektuara përmes përthyerjeve, ku forma e stili paracakton diskursin, si mënyrë shprehjeje e kodeve të tilla.

Historia do të jetë bazamenti universal e referencial nga i cili Pashku do të ndërtojë linja të reja e të përthyera, pra si kode e diskurse historike, biblike, popullore.

¹ S. Hamiti, *Tematologjia*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2005, f. 33.

Pashku: modeli i shkrimit

Ndonëse për Pashkun është shkruar shumë, megjithatë ai nuk është i lehtë për t'u kuptuar.

Për ta kuptuar mirë, duhet pasur parasysh disa nga kodet, që pastaj ndërliken me diskursin, e këto së bashku bëhen figurë/tekst i figuruar, si përcaktuese e çelës leximi/interpretimi.

Modeli i shkrimit të Pashkut është modeli krijues. Këtu po i referohemi Sabri Hamitit, alias Letërsisë e shkallës së parë, "që e karakterizon krijimi apo poiesisi"².

Në këtë studim, Sabri Hamiti nxjerr përfundime se në vështrimin e zhvillimit e të komunikimit universal, letërsia shqipe si dhe letërsitë e tjera kalojnë nëpër tri shkallë e që i quan:

1. *"Letërsia në shkallën Zero*
2. *Letërsia në shkallën e parë dhe*
3. *Letërsia në shkallën e dytë"*³

Sipas tij, këto shkallë janë karakterizuese e jo vlerësuese dhe si të tilla janë të larguara njësoj nga qendra.

"Shkalla Zero e letërsisë (termi është analog me të Rolan Bartit: Shkalla Zero e shkrimit) karakterizohet nga imitimi (mimesis).

*Shkalla e parë karakterizohet nga krijimi (poiesis) ... dhe Shkalla e dytë nga rikrijimi (metapoiesis)"*⁴.

Ndërsa, ndërlikenja ligjëimore, apo ajo që Sabri Hamiti e shenjon si: *"Kodet e diskursit", studion ligjëritë e përgjithshme, për të nxjerrë "karakteristikat apo identitetin e një letërsie nacionale, qoftë të krahasueshme me letërsi të tjera", të cilat janë: kodi e diskursi heroik, kodi e diskursi popullor, kodi e diskursi biblik dhe kodi e diskursi historik.*

*Meqë me kodin e diskursit heroik "të folurit legjendar e legjendarizues kthehet vështirë e me dhembje dramatike në shkrim. Kjo ndodh sidomos kur skema e vjetër është shumë e gjallë, por nuk funksionon mirë në botën e modernitetit, që mbështetet në dëshmi e në funksion"*⁵.

² Po aty, f. 48.

³ Po aty, f. 47.

⁴ Po aty, f. 47-48.

⁵ S. Hamiti, vep. e cit., f. 54.

Atëherë, ky element nuk është karakterizues kësaj here, apo tipizues për shkrimin e Pashkut.

Përmendim këto elemente të rëndësishme e të cilat do të bëhen esencë për të depërtuar në brendinë e veprës së tij, për ta parë vendin e Pashkut në letërsi, si dhe modelin e tij të shkrimit.

Shenjuesi i vënë në titull “Anton Pashku: Kodet e mëdha” e me referencë romanin “Oh” vendoset në grupin e dytë, apo në letërsinë e shkallës së parë, alias krijimit, ose poesisit.

Kjo për arsyen elementare se Pashku solli një model e strukturë të re shkrimi, që e bën prijës të modernitetit në “Shkollën letrare moderne në Kosovë”.

Duke qenë se fjalët çelës për të hyrë në interpretimin e veprës së tij janë etnia/pushtuesi/okupatori, atëherë ne jemi në hapin e parë drejt hyrjes në studim/interpretim.

Nga aspekti narrativ/rrëfyes, teksti i Pashkut është i koncentruar e me ngarkesa dhe i fuqishëm psikologjikisht dhe herë i ftohtë e herë me ngarkesa emocionale. Gjërat që duken rrethanore, apo të dorës së dytë, nganjëherë bëhen e janë esencë në veprën e Pashkut.

Kodi e diskursi historik

Studiuesi Bajram Krasniqi⁶, i cili për fatin e keq ka vdekur i ri, ka një punim doktore, të shkëlqyeshëm, me fushë studimi romanin historik.

Ai, në mënyrë të shkëlqyeshme studion romanin historik me elementet e tij, të cilat i ka ky lloj romani me premisa fillestar dhe elemente qenësore ndërtimi, historia, personazhi historik dhe ngjarja historike.

Vepra “Oh” e Pashkut, nuk është vepër/roman historik në kuptimin klasik të fjalës, por gjithsesi, vepër që brenda saj shpalos një pjesë të historisë sonë kombëtare, elementet gjenerale të një kohe, si ekuivalencë dhe emërues i përbashkët për vazhdimësinë e fatit historik, si segment i veçantë e i ndërlidhur me anën negative të historisë.

⁶ Shih: Dr. B. Krasniqi, *Poetika e romanit historik*, Prishtinë, 1978.

Një studiues tjetër brilant i Pashkut, Rexhep M. Shala⁷, vlerëson se një ndër elementet e rëndësishme të veprës së Pashkut është edhe shpërfaqja/pasqyrimi i elementeve negative të historisë. Kjo të ndërlidh me kodin historik, por me një diskurs krejt të figuruar.

Historia jo si dokument, por si dëshmi narrative e bartur nga Plaku/ekuivalenca historike, që në tekstin letrar merr rol interpretues të historisë, njëherësh për të mësuar nga historia (tradhtia), në udhëtimin historik mijëravjeçar të Plakut.

Gjithë kjo del si refleksion nga teksti i figuruar dhe nga shenjuesit “kangë” e “barkë-çifteli”, si elemente të trashëgimisë dhe bartëse të historisë brez pas brezi.

“A të duket e bukur ajo barkë?”

Kur asht plot, duket fort e bukur. Duket, si me thanë, duket, nga bregu i ujit duket, si me thanë, duket si çiftelia. Luen mbi valë. Përkundet si zonjë ... Luen mbi valët që sulen kah ajo, por ajo s’jau ven veshin. Luen. Dhe valët trenohen kur e shohin tue luejtë. Sulen kah ajo, por s’i bajnë gja. Ajo vazhdon me luejtë, dhe prej saj përhapen tingujt, të cilët përpiqet me i gëlltitë zhumhuri i valëve. Shumë tinguj mbyten në zhumhurin e valëve, aty pranë barkës-çifteli. Disa të tjerë kapërcejnë prej valës në valë dhe mbërrijnë deri në breg të ujit. Aty prap nisen të shumohen. Bahen aq shumë, sa nuk mund t’i njehë askush. Shkrihen në njani tjetrin. Dalin prej njani tjetrit. Kangë. Po, tash e ndëgjoj një kangë, që çan mjegullën para syve të mi.”⁸

Kënga, tingujt, valët, barka-çifteli janë elemente e figura narrative, që zbërthimi i tyre përkthen tekstin në tregim historie.

Kodi e diskursi popullor

Studiuesi tjetër, gjithashtu i rëndësishëm, Kujtim Rrahmani⁹, në studimin e tij “Intertekstualiteti dhe oraliteti”, duke studiuar Pashkun nga niveli intertekstual, nxjerr në pah elementin popullor, si taban mbi të cilin ndërton Pashku.

⁷ Shih: R. M. Shala: *EX LIBRIS- moderna pashkiane*, Papyrus, Prishtinë, 2000.

⁸ A. Pashku, *Oh, Rilindja*, Prishtinë, 1986, f. 51, 52.

⁹ K. Rrahmani: *Intertekstualiteti dhe Oraliteti* – E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku, Prishtinë, 2002.

Duke qenë se Anton Pashku ishte njohës i shkëlqyeshëm i Letërsisë popullore, duke ditur se në të fshihen margaritarët e shpirtit të popullit, duke parë vlerën e saj dhe brumin nga i cili mund të ndërtohen linja e modele të reja kuptimore e formale nga po ky brumë, ai bën një përzgjedhje dhe sjell elemente krejt të reja, për të ndërtuar një model të veçantë, në kod e diskurs popullor.

Personazhi/Plaku që brenda botës letrare të Pashkut kthehet në figurë, brenda tekstit të figuruar/simbolik, ai bëhet bartës i dijes e urtisë popullore, që esencialisht del i barasvlershëm me përvojën që e bartë mbi supe.

Brenda veprës së Pashkut, rrëfimi/ligjërimi (diskursi) që rrjedh nga goja e Plakut, domosdoshmërisht duhet parë nga ndërlidhjet fjalë-fjali-frazë, sepse nëse kjo kalohet ndryshe, atëherë mund të rrëshqasim nga kuptimi i plotë i mesazhit të Plakut.

Rrëfimi i tij, dialogët më e Atë janë brilantë dhe tejet të fuqishëm artistikisht e semantikisht.

Kjo mënyrë diskursi, brenda kodit popullor, thuhet vërehet në gjithë veprën; ne do të përmendim dy raste; atë të Plakut dhe atë të Babës.

Që të dy këto personazhe/figura dalin tejet të ndërlidhura ngushtë me vendin, trollin. I pari me Malin dhe i dyti me Tokën, që figurativisht janë e njëjta gjë dhe që lidhja e tillë dëshmon një dhembje e një dashuri, një vuajtje e një gëzim dhe një sakrificë deri në flijim.

Dialogu në mes të Plakut dhe Atij për malin është mjaft interesant, e që ndërlidhet me një mentalitet brezash. Derisa Ai nuk është i lidhur ngushtë me malin dhe në një mënyrë ironizon me Plakun për të, realisht ai mal për Plakun është vetë jeta.

Rrëfimi i Plakut është diskursivisht popullor, me figura popullore e të cilat komunikojnë edhe sot mjaft gjallë.

“Dikur ajo e pyeti për drujt e asaj ane. Ai tha se atypari ka shkozë e murriz, ndërsa pakë ma nalt edhe druj të tjerë, besa edhe shumë lisa të gjatë, degëhapët, trungjet e të cilëve nuk mund t'i përthekojnë as dymbëdhjetë burra; në zguer të një asi lisi, tha ai me krenari të pakuptueshme për mue, dimnin mund ta kalojnë

*dymbëdhetë ujë dhe dymbëdhetë desh, pa e pa njani tjetrin asnjë herë.*¹⁰

Ndërlidhja në mes të Plakut dhe malit si diskurs popullor, në planin kuptimor/semantik dhe atë të idesë shkon përtej kësaj.

Por, shembulli i dytë ai i Babës dhe dheut do të merret si barasvlerësim dhe për të ndërtuar paralele mes dy figurave të pranishme në tekstet e kodeve e diskurseve popullore; Plaku/Baba dhe Mali/Dheu, si jetesë e mbijetesë.

*“Kurse Baba im nuk do me hypë në çatinë e botës. Atij i pëlqen me mbetë në çatinë e shtëpisë së vogël përdheke... I pëlqen të bahet dhe për atë dhe të vogël, fushë me hullina, fushë e blerueme, fushë me lulekuqe...”*¹¹

Rrëfimet e tilla marrin përmasa të rrëfimit e tregimit popullor, me refleksion e figuracion hiperbole.

Elemente të tilla narrative janë të shtrira gjatë gjithë tekstit, herë të gërshetuara me refleksione të pastërta popullore e herë të kombinuara edhe me ato historiket. Pra herën e parë si trashëgimi popullore. Herën e dytë si refleksion historik, përmes diskursit popullor

Kodi e diskursi biblik

Së fundmi, Ndue Ukaj¹², në studimin e tij “Kodi e diskursi biblik”, studion këtë kod e diskurs në letërsinë shqipe, element të cilin natyrisht që e vëren edhe te Pashku.

Ngjarja në romanin “Oh” ndodh në mes të Atij dhe Asaj. Ajo që ndodh në mes të hyrjes dhe fundit, përbën esencën e tekstit në këtë nivel, e kthyer në retrospektivë e që vjen si kujtesë/imagjinatë.

Kujtesa vjen nga shkrimi/leximi, ndërsa imagjinata rrjedh, derivon nga leximi.

Dy personazhet, Ai dhe Ajo shpërfaqin idenë e dy njerëzve në një botë të vetmuar dhe shpirtërisht boshe, me kundërshtitë

¹⁰ A. Pashku, vep. e cit., f. 43.

¹¹ A. Pashku, vep. e cit., f. 133

¹² Shih: N. Ukaj, *Diskursi biblik në letërsinë shqipe*, AIKD, Prishtinë, 2004.

pasivitet/aktivitet, ëndërr/realitet, si ekuivalencë e njerëzve të parë biblik, Evës dhe Adamit.

Ky element më duket të dalë i ndërlidhur si ide edhe nga Abeli i Haxhiademit.

Teksti/narracioni është i figuruar e i rimuar dhe kur jemi te kodi e diskursi biblik edhe si prozë poetike.

Citojmë katër rreshtat e fundit të dialogut në mes të Atij dhe Asaj, për ta parë natyrën e tillë poetike/biblike:

“– Lum për mue, me kë duhet me mejtue!

– A mos e ke me mue?

– Ani, qofsh bekue.

– Amen.”¹³

Teksti i Pashkut duke qenë simbolik dhe i figuruar, atëherë dialogët e tillë rrjedhimisht reflektojnë kuptimisht e esencialisht kodin e diskursin biblik.

Përfundim

Romani “Oh” i Anton Pashkut, është një rrëfim brilant. Pashku dëshmon një mjeshtri shkrimi, ku struktura e stili përcakton diskursin, si model e kod shkrimi, si figurë e si ide.

Shenjuesi formal i titullit “Oh”, del të jetë i mishëruar dhe refleksion i strukturës së brendshme, që si tip shkrimi/rrëfimi lë mundësi të shumta studimi/interpretimi.

Pasthirrma “Oh” është dhembje e fsharje, që historikisht na ka përcjellë.

Dhembja e tillë bëhet fsharje kur ajo merr përmasat e tradhtisë, e posaçërisht kur kjo ndodh brenda vet nesh, nga ku përmasat e saj sjellin rrënimin.

Ky refleksion përshkon pjesën më të madhe të veprës, pa marrë parasysh kodin e diskursin.

Kodet e mëdha nuk reflektojnë prerjet e mëdha brenda veprës, por janë vetëm mënyrë rrëfimi/diskursi që pasqyrojnë variante interpretimesh.

¹³ Anton Pashku, vep. e cit., f. 40.

Dhe, ajo që është e rëndësishme për veprat e mëdha, pas çdo përfundimi të leximit, të hapet një dritare e re dhe një dëshirë e re leximi dhe interpretimi njëkohësisht.

Kjo ndodh me Pashkun, me mjeshtrin e madh dhe rrëfimtarin e lindur.